

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1046 Prot.

Tiranë, më 02.082017

VENDIM Nr. 165, datë 26.07.2017

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), VKM Nr. 280, datë 01.04.2015 "Për përcaktimin e kriterëve, procedurave të dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi në ndërtimet me leje". Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.10. të datës 26.07.2017. pasi shqyrtoi Kërkesën e ALUIZNI-it Durrës për konfirmim nga KKA. për vijimin e procedurës së legalizimit të objektit të Z. Fatmir Kiptiu, Lagjia Nr. 17, rruga "Prokop Sorra", i cili pozicionohet brenda zonës arkeologjike "B" të qytetit të Durrësit,

VENDOSI:

1. Të miratojë Kërkesën e ALUIZNI-it Durrës për konfirmim nga KKA, për vijimin e procedurës së legalizimit të objektit të Z. Fatmir Kiptiu, Lagjia Nr. 17, rruga "Prokop Sorra" i cili pozicionohet brenda zonës arkeologjike "B" të qytetit të Durrësit. .
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUBINA ZOTO